

Rruga drejt së vërtetës 28



Fillimisht le të ndjekim ajetin **75** të sures **Bekare**:

" A shpresoni se do t'u besojnë ata juve (jehuditë), kur dihet se një grup prej tyre dëgjuan fjalët e All-llahut, edhe pse i kishin kuptuar, e duke qenë të vetëdijshëm (ç'bënin) i ndryshuan ato".

Në fillim të shfaqjes së islamit pritej që jahuditë të pranonin të parët islamin, sepse ata ndryshe nga idhujtarët ishin besimtarë të librit dhe në librat e tyre ishin dhënë shenjat e profetit të Islamit por ata u radhitën përkrah idhujtarëve kundër myslimanëve. Ku ajet ngushëllon profetin e Islamit dhe myslimanët duke u thënë se nëse e shohin se jahuditë nuk pranojnë islamin dhe ajetet Kuranore, të mos brengosen dhe të mos kenë dyshime në fenë e tyre dhe të mos presin diçka të tillë prej jahudive sepse ata janë bijtë e atyre që sëbashku me hazretin Musa(as) shkuan në malin Tur dhe dëgjuan fjalën e Zotit por e ndryshuan atë dhe nuk i qëndruan besnik fesë së tyre. Ky ajet tregon se një nga rreziqet që kanos dijetarët e çdo populli është manipulimi is ë vërtetës për popullin. Megjithëse ata e dinë dhe e kuptojnë të vërtetën e manipulojnë atë në mënyrë që popullit të mos e kuptojë. Në vazhdim le të ndjekim ajetet 76 dhe 77 të sures Bekare: " E kur takonin ata që kishin besuar (muslimanët) thonin: "Ne kemi besuar! E kur veçoheshin ata mes veti thonin: "A po ju tregoni atyre (muslimanëve) për atë që All-llahu ua shpalli juve (në Tevrat rreth Muhammedit a. s.) që ata para Zotit tuaj të kenë argumente kundër jush. A nuk jeni duke kuptuar". Më Zoti u përgjigjet atyre dhe thotë: " A thua nuk e dinë ata (jehuditë) se All-llahu e di atë çka e fshehin dhe atë çka e publikojnë"?

Në fillimet e Islamit disa jahudi kur shikonin myslimanët u thonin: " Meqenëse shenjat e Profetit tuaj janë në Teurat në besojmë në fenë tuaj". Por kur këta persona takoheshin me njëri-tjetrin kritikonin njëri-tjetrin se përse u rikujtojnë myslimanëve shenjat e Muhamedit(savs) të përmendura në Teurat. Rezultati i manipulimit të së vërtetës nga dijetarët e popullit çifut dhe pranimit i këtij manipulimi nga jahuditë u bë shkak që sot të ekzistojnë miliarda jahudi dhe të krishterë në botë.

Le të ndjekim tani ajetin **78** të sures **Bekare**:

" E ka disa prej tyre që janë analfabetë, nuk e kuptojnë librin, por jetojnë vetëm në shpresa, duke mos qenë të sigurt ".

Ky ajet flet për një grup tjetër të Beni israilëve të cilët ishin ndryshe nga grupi i dijetarëve që kishin manipuluar të vërtetat e Teuratit në lidhje me profetin e Islamit dhe jetonin me dëshirat e tyre. Ata mendonin se në Teurat populli jahud konsiderohet si racë superiore dhe të përzgjedhur të Zotit dhe vetëm ata në ditën e kiametit do të shpëtojnë dhe nuk do të shkojnë në xhehenem dhe në rast së dënohen, dënimi i tyre nuk do të zgjasë më shumë se disa ditë. Ka mundësi që të tilla mendime dhe dëshira të ekzistojnë edhe tek pasuesit e feve të tjera hyjnore por duhet ta dimë se

këto janë rezultat i paditurisë dhe mosnjohjes së librave të Zotit, sepse në asnjë nga librat qiellorë nuk ka vend për të tilla mendime.

Tani le të ndjekim ajetin **79** të sures **Bekare**:

" Është shkatërrim për ata që me duart e veta e shkruajnë librin, e pastaj thonë: "Ky është nga All-llahu!, e për të arritur me te një fitim të paktë, pra është shkatërrim i madh për ta çka shkruan duart e tyre dhe është shkatërrim i madh për ta ajo çka fitojnë".

Gjatë gjithë historisë kanë ekzistuar dijetarë të cilët e kanë shfrytëzuar fenë për qëllimet e kësaj bote. Ata janë si ata tregëtarë të cilët shesin mallra origjinale për të marrë mallrat të skaduara. Këta idhujtarë të pasurisë, të veshur me robat e fesë, e shesin fenë për të fituar psurinë e përkohshme të kësaj bote. Abuzimi me fenë e Zotit për të fituar përkrahjen e popullit apo poste dhe pasuri, apo për të ruajtur intersat personale dhe klanore është një rrezik i madh për njerëzit dhe ajeti i mësipërm duke përmendur disa herë fjalën shkatërrim tregon qartë sesa kërcënues është ky rrezik.

Të nderuar dëgjues nga këto ajete mësojmë:

1- Është mirë të pritët që të gjithë njerëzit të besojnë, por duhet ta dimë se shumë njerëz nuk janë të gatshëm të pranojnë të vërtetën prandaj mosbesimi i tyre nuk duhet të krijojë dyshim dhe tronditje të besimit tonë.

2- Tradhtia më e madhe është tradhtia kulturore. Manipulimi dhe tjetërsimi i të vërtetës është një tradhti e cila i privon brezat e ardhshëm nga kuptimi i të vërtetës dhe shkakton devijimin e shoqërisë.

3- Distancomi i ndjekësve të feve nga librat qiellore dhe sidomos nga Kurani krijon kushtet për zgjerimin e besëtytnive dhe e paragjykimeve të kota dhe padituria është burimi i këtij problemi të madh.

4- Abuzimi dhe shitja e fesë nga ana e dijetarëve është një rrezik i madh për popullin prandaj njerëzit duhet të kenë kujdes dhe të mospranojnë cdo fjalë që u thuhet edhe nëse oratori është veshur me rrobat e fesë.

Marre nga: <http://albanian.irib.ir>